

VENDIM
Nr.641, datë 28.7.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE
PUBLIKE, NË BASHKINË E PËRMETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, në bashkinë e Përmetit.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Përmetit.
 3. Pasuritë, në sipërfaqen prej 3996 (tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m² tokë arë, pronë private që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen, janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
 4. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, është 2 197 800 (dy milionë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Përmetit, planifikuar në buxhetin e vitit 2010.
 5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj, pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Përmetit.
 7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Përmetit, për realizimin e këtij projekti.
 8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 3 996 (tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m² tokë arë, shpronësuar në favor të bashkisë së Përmetit, të bëhet brenda 30 ditëve, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Përmetit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË
SHPRONËSOHEN PËR “ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT”,
NË BASHKINË E PËRMETIT

Nr	Emër, mbiemër	Sip.arë	Çmimi lekë	Vlera lekë	Dokumenti i pronësisë	Zona kadastrale
1	Muço Karafili	1710	550	940500	Certifikatë pronësie	1589
2	Syrja Zengjinasi	1140	550	627000	Vërtetim Pronësie	1589
3	Bramo Krafili	1146	550	630300	Vërtetim pronësie	1589

	Totali	3996		2 197 800		
--	---------------	-------------	--	------------------	--	--